



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 3493 Prot.

Tiranë, më 10/06/2020

URDHËR

Nr. 168, datë 10.06.2020

“PËR
EVIDENTIMIN DHE MARRJEN NË DORËZIM TË ARKIVAVE TË PADORËZUARA
NDËR VITE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 142, pika 10, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”,

URDHËROJ:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë kryen verifikimin në regjistrin e noterëve, duke evidentuar në një listë të gjithë noterët të cilëve iu është hequr licenca e ushtrimit të profesionit të noterit dhe për të cilët në regjistër nuk ka të dhëna mbi noterin që ka marrë në dorëzim arkivin.
2. Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë kryen verifikimet përkatëse dhe nxjerr nga arkiva të gjithë urdhrat e Ministrit të Drejtësisë për heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit të noterit, të cilët përmbajnë dhe detyrimin e dorëzimit të arkivit dhe vulave noteriale, si dhe për marrjen në dorëzim të arkivave të ish-noterëve.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë mund të kërkojë bashkëpunimin e Dhomën Kombëtare të Noterisë për të evidentuar nëse arkivat janë marrë në dorëzim nga noterët dhe noterin që ka marrë në dorëzim arkivën.



Dhoma Kombëtare e Noterëve nëse ka dijeni, informon nëse arkivat mbahen në ngarkim nga persona të tretë.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Noterisë, identifikon noterët që kanë ndërruar jetë, trashëgimtarët e tyre ligjorë apo testamentarë, të cilët mund të kenë dijeni apo kanë në ngarkim arkivën e padorëzuar.
5. Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë kërkon bashkëpunimin e Zyrave të Gjendjes Civile për përcjelljen e certifikatave familjare të ish noterëve me qëllim identifikimin e personave të cilët mund të kenë dijeni apo kanë në ngarkim arkivën e padorëzuar.
6. Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pas evidentimit të listës së plotë të ish noterëve që nuk kanë dorëzuar arkivën noteriale, brenda 45 ditëve pune, dërgon njoftimin, me postë të porositur, për dorëzimin prej tyre apo prej personave të tretë, në mënyrë vullnetare të arkivës përkatëse.
7. Për marrjen e arkivit në dorëzim, personi (ish-noteri, personi i ngarkuar prej tij ose personi që ka në ruajtje arkivin), njoftohet të paktën 10 ditë përpara për ditën dhe orën e dorëzimit dhe i jepet edhe një kopje e urdhrin të Ministrit.
8. Kur personit nuk i dihet vendbanimi, si dhe kur njoftimi nuk mund të kryhet në asnjë prej vendeve të përcaktuara në nenin 151 të Kodit të Procedurës Administrative, kryhet njoftimi publik sipas parashikimit të nenit 162 të Kodit të Procedurës Administrative.
9. Në rast moszbatimi vullnetar, urdhri i Ministrit të Drejtësisë për dorëzimin e dokumentacionit që përmban arkivi i noterit, përbën titull ekzekutiv dhe ngarkohet zyra e përmbarimit me ekzekutimin e tij sipas parashikimeve në ligjin për noterinë.
10. Ministria e Drejtësisë merr masa për ndjekjen e procedurave ligjore për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit mbi titullin ekzekutiv. Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë i kërkon sektorit të përfaqësimit gjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë paraqitjen e kërkesës për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit. Sektori i përfaqësimit gjyqësor paraqet në gjykatë kërkesën brenda 20 ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuara në pikën 7 ose 8 të këtij urdhri. Pas lëshimit të urdhrin të ekzekutimit Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë i kërkon zyrës së përmbarimit shtetëror vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv. Ministria e Drejtësisë ndjek procedurat ligjore për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit mbi titujt ekzekutivë, urdhrat e Ministrit të Drejtësisë për heqjen e licencës së ushtrimit të veprimtarisë noteriale dhe marrjen në dorëzim të arkivës noteriale.
11. Me administrimin e urdhrave përkatës të ekzekutimit, nxirret urdhri për ngritjen e komisioneve për marrjen në dorëzim të arkivave noteriale me përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe Degët Vendore dhe dorëzimin e tyre noterëve të caktuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.



12. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë.
13. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Etilda Gjona
ETILDA GJONAJ (SALIU)

